

Komuna e

Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove
Komuna e Gjakovës
Nr. Br. 617101 - 2482
Data 24.08.2018
Gjakovë - Djakovica - Gjakova

Komuna e Junikut

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

I lidhur me datën 24.08.2018 në mes të palëve:

1. Komuna e Gjakovës të cilën e përfaqëson Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës, në tekstin vijues Komuna e Gjakovës;
2. Komuna e Junikut të cilën e përfaqëson Agron Kuçi, Kryetar i Komunës së Junikut, në tekstin vijues Komuna e Junikut;

Neni 1 Baza Ligjore

Ky Memorandum Mirëkuptimi i lidhur në mes të Komunës së Gjakovës dhe Komunës së Junikut për hapjen e paraleles së ndarë të shkollës së mesme të Mjekësisë "Hysni Zajmi" të Komunës së Gjakovës në Gjimnazin "Kuvendi i Junikut" është bazuar në nenin 13 të Ligjit NR.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 13 paragrafi 2 të ligjit për Arsimin Universitar si dhe Udhëzimit Administrativ (MASHP) Nr.29/2012 për themelimin e paraleleve të ndara.

Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është hapja e paraleles së ndarë të Shkollës së Mesme të Mjekësisë "Hysni Zajmi" të Komunës së Gjakovës, në Gjimnazin "Kuvendi i Junikut" në Junik.

Neni 3 Obligimet e palëve

Komuna e Gjakovës, respektivisht Shkolla e Mesme e Mjekësisë "Hysni Zajmi" do të ofron staf mësimdhënës për lëndët profesionale në paralelen e ndarë në Junik.

Komuna e Junikut, respektivisht Gjimnazi "Kuvendi i Juniku" do të ofroj staf për lëndët e njohurive të përgjithshme.

Neni 4

Ky Memorandum mirëkuptimi është e përpiluar në katër (4) kopje identike nga dy kopje për të dyja palët.

Palët

Kryetari i Komunës së Gjakovës

Ardian Gjini

Kryetari i Komunës së Junikut

Agron Kuçi